



VKM nr 248

Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara

Në mbështetje dhe në zbatim nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar





Pyetjet më të shpeshta

KUSH MUND TE APLIKOJE?

Të gjithë subjektet punëdhënëse, persona fizikë dhe juridikë.

CILAT JANË KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË PUNËDHËNËSI QË DËSHIRON TË APLIKOJË?

- ◆ Nuk duhet të ketë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës.
- ◆ Duhet të ketë derdhur, rregullisht, tatimet e sigurimet e detyrueshme shoqërore, për aq kohë sa kryen veprimtarinë.

SA ËSHTË NUMRI I PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË PËR TË CILËT MUND TË APLIKOJË E PËRFITTOJË NJË SUBJEKT PUNËDHËNËS?

Nuk ka kufizim.

KOHËZGJATJA DHE FINANCIMI I PROGRAMIT

Programi ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh me të drejtë riaplikimi për 12 muaj të tjerë.

- a) Punëdhënësi, fiton një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.
Ky financim bëhet nga Zyra e Punësimit në degën e sigurimeve shoqërore sipas procedurave përkatëse;
- b) Punëdhënësi, përfiton një financim për të pajisuar siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuara dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona. Për këtë, punëdhënësit duhet të paraqesin një projekt për përshtatjen e arsyeshme;



Pyetjet më të shpeshta

- c) Punëmarrësi, punëkërkuksi i papunë, person me aftësi të kufizuar, sipas këtij programi, merr një financim mujor në masën deri 100 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi për 6 (gjashtë) muajt e parë të punësimit;
- c) Deri në 50 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e dytë të punësimit.
- e) Punëkërkuksit e papunë me aftësi të kufizuara të përfshirë në program sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, nuk e humbasin pagesën që përfitojnë për shkak të aftësisë së kufizuar.

SKEMA E PËRFITIMIT FINANCIAR PËR BIZNESET



12 MUAJ SIGURIME SHOQËRORE
(me të drejtë riaplikimi
për 12 muaj të tjerë)

MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12



12 PAGA
(me të drejtë riaplikimi
për 12 muaj të tjerë)

MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI	MUAJI
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

100% e pagës minimale

50% e pagës minimale



Pyetjet më të shpeshta

A FINANCON ZYRA E PUNËSIMIT PËR FORMIMIN NË PUNË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA?

Zyra përkatëse e punësimit financon për formimin në punë të personave me aftësi të kufizuara

KUSH MUND TË MARRË PJESË NË PROGRAMET E FORMIMIT NË PUNË?

Persona me aftësi të kufizuara, të pakualifikuar profesionalisht dhe që janë të rregjistruar pranë Zyrës së Punësimit

SA ËSHTË NIVELI I FINANCIMIT PËR KËTË PROGRAM

- a) Punëdhënësi, paguhet deri në 70 për qind të tarifave me bazë koston e trajnimit;
- b) Kursanti, punëkërkues i papunë, i përfshirë sipas këtij programi, paguhet në masën deri në 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi;
- c) Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, derdh kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.3 për qind të pagës minimale, sipas procedurave përkatëse.



Kohëzgjatja


SA ËSHTË KOHËZGJATJA E PROGRAMIT TË FORMIMIT NË PUNË?

Kohëzgjatja e programit të formimit në punë, është jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj për të gjitha profesionet.

A EGZISTOJNË MUNDËSI PËR PUNËSIM PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMIT TË FORMIMIT?

Në përfundim të periudhës së formimit, punëdhënësit duhet të punësojnë jo më pak se 30 për qind të të trajnuarve, për një periudhë 6-mujore.

SKEMA E PËRFITIMIT



■ Financimi i Zyrës së Punësimit

■ Kontributet nga ana e Biznesit

*Periudha e trajnimit në varësi të profesionit.



SI DHE KU MUND TË APLIKOHET

1. Punëdhënësi duhet të plotësojë formularin e aplikimit, të cilin mund ta shkarkojë nga faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, www.shpk.gov.al e ta dërgojë në mënyrë elektronike, apo me zarf pranë Zyrave të Punësimit.
2. Sëbashku me formularin, duhet të paraqesë pranë Zyrës Përkatëse të Punësimit, ku ai zhvillon veprimtarinë, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik apo fizik ose vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
 - b) Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);
 - c) Vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që lëshohen nga organi tatimor përkatës, për atë kohë sa ushtron veprimtarinë, për subjektet me kohëzgjatje aktiviteti më pak se një vit, dhe për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimi, për subjektet me kohëzgjatje aktiviteti prej më shumë se një viti;
 - ç) Numrin e llogarisë bankare;
 - d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për atë kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;
 - dh) Informacion për:
 - i) numrin e fuqisë punëtore;
 - ii) listën e të siguruarve;
 - iii) llojin e veprimtarisë që kryen;
 - iv) nivelin e pagës së dhënë, për çdo person;
 - v) planbuznesin për shtimin e fuqisë punëtore.
 - vi) Akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. (të vitit të fundit nëse ka)